



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

GJIMNAZI SHKENCA NATYRORE



Prishtinë, qershor 2010

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t'u përgjigjeni 100 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigjiu pyetjeve në vijim

“O, zot, kurr ditën e vet mos e pafshin, që nuk na lanë të jetojmë në shtëpinë tonë, po na i dhanë këto udhë të gjata, që doni kështu të na qitni fare. Dashtë zoti e kurr mos u shtofshi, e mos ngulshi themele në tokën tonë!” fliste nëna dhe sytë i shkëlqenin. Kurrë nuk e kam parë që sytë t’i shkëlqejnë kështu, kurse fytyra t’i kishte marrë atë pamje që sikur digjej flakë. “Doni të na faroni kështu, vetë u farofshi, o zot. Shpëtim gjetshim, ne të pafajshmit, edhe në këtë rrugë. E, një ditë, u kthefshim prapë në këto troje se larg tyne nuk kemi me e pasë jetën tonë të gjatë...” Fliste ajo. Thuajse nuk i kishte mbetur më fije shprese se po i iknim kështu vdekjes se ne po bënim rrugën e shpëtimit... Mezi, duke u dridhur dhe pa trohë fuqie po i bënte hapat e ngathët të atyre këmbëve të dërmuara, që megjithëse ashtu të futura në dhe po e largonin andej edhe pse i dukej që po i shkëputej dhe aty po i mbetej një copë e vetvetes.

(Nazmi Rrahmani: “Rruga e shtëpisë sime”)

1. Vendin, si zonë gjuhësore, ku ndodh ngjarja e përshkruar mund ta kuptojmë nga fjalja:
 - A. Thuajse nuk i kishte mbetur më fije shprese
 - B. “larg tyne nuk kemi me e pasë jetën tonë të gjatë”
 - C. Shpëtim gjetshim, ne të pafajshmit, edhe në këtë rrugë
 - D. “që nuk na lanë të jetojmë në shtëpinë tonë”

2. Në fragmentin e mësipërm, nëna flet për:
 - A. shkëlqimin e syve të saj
 - B. lodhjen që i mundonte
 - C. ikjen pa shpresën për t’u kthyer
 - D. ikjen me shpresën për t’u kthyer

3. Folja në fjalinë: “*kurrë mos u shtofshi*”, është në mënyrën:
 - A. habitore
 - B. dëftore
 - C. dëshirore
 - D. urdhërore

4. Në fjalinë: “*pa trohë fuqie po i bënte hapat e ngathët*”, hasim mbiemrin në shkallën:
 - A. pohore
 - B. sipërore
 - C. krahasore të barazisë
 - D. krahasore të ultësisë

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

Neni 33

(6) Nëse disa persona fajësohen për disa vepra penale, gjykata mund të vendosë të zbatojë procedurë të bashkuar dhe të marrë një aktgjykim me kusht që veprat të jenë të ndërlidhura dhe provat të jenë të përbashkëta.

(7) Gjkata mund të vendosë të zbatojë procedurë të bashkuar dhe të marrë një aktgjykim, po qe se para të njëjtës gjykatë zbatohen procedura të ndara kundër të njëjtit person për disa vepra ose kundër disa personave për vepër të njëjtë.

(8) Për bashkim të procedurës vendos gjykata e cila është kompetente për zbatimin e procedurës së përbashkët në bazë të propozimit të prokurorit publik ose sipas detyrës zyrtare.

(Ligji i Procedurës Penale i Kosovës)

5. Fragmenti i mësipërm ka tipare diskursive të shkrimit:

- A. letrar
- B. gazetaresk
- C. kodifikues
- D. eseistik

6. Periudha në paragrafin (7), në bazë të mjeteve lidhëse, është periudhë me marrëdhënie:

- A. lejore
- B. shkakore
- C. kundërshtore
- D. kushtore

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

“Sulmi ishte “thembra e Akilit” e ekipit tonë”, tha mbrëmë në Barcelonë trajneri i kuqekaltërve pas ndeshjes që ekipi i tij e fitoi me rezultat minimal kundër Interit, duke mos arritur të kalojë në finale. Kronikën që do ta shikoni në vazhdim e ka përgatitur gazetari ynë.

(Lajm i përshtatur)

7. Nëse faktet do t’i rendisnim duke iu përgjigjur kronologjikisht pyetjeve themelore:

“kush, çka, kur ku”, do të kishim fjalinë:

- A. Trajneri i kuqekaltërve mbrëmë në Barcelonë tha se...
- B. Trajneri i kuqekaltërve tha mbrëmë në Barcelonë se...
- C. Mbrëmë në Barcelonë, trajneri i kuqekaltërve tha se...
- D. Mbrëmë, trajneri i kuqekaltërve tha në Barcelonë se...

8. Fjala “thembra e Akilit” e ka kuptimin:

- A. pika më e dobët
- B. pika më e fortë
- C. problem i pazgjidhshëm
- D. problem i zgjidhshëm

9. Në fjalinë: “Kronikën që do ta shikoni në vazhdim e ka përgatitur gazetari ynë”, e-ja është:

- A. pjesëz
- B. lidhëz
- C. nyjë e përparme
- D. trajtë e shkurtër

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

T'kjosim falë, o i Madhi Zot,
Sa shpejt diellin m'a xû rêja!
Shpejt m'a êndi 'i pëlhurë t'gjânë e t'gjatë!
E i ká veshun majet rreth e rrotull,
Qi kúr janë kapë trimat tu lumi,
Kaq përzí i ká frima plajm e rê,
Askurnjâ shoshojnë trimat s'p'e njofin

- 10.** Ky fragment është shkëputur nga:
- A. Kënga e Rinjohjes
 - B. Këngët e Gjergj Elez Alisë
 - C. Këngët e Kreshnikëve
 - D. Kënga e Ago Ymer Agës
- 11.** Vargje të tipit: “*T'kjosim falë, o i Madhi Zot!*”, ku kërkohet ndihma e fuqive mbinatyrore, hasen edhe te:
- A. Odiseja e Homerit
 - B. Epi i Gilgameshit
 - C. Rubaitë e Khajamit
 - D. Antigona e Sofokliut
- 12.** Krijimet popullore, pjesë e të cilit është ky fragment, shquhen për:
- A. rimën e rregullt
 - B. metrikën e rregullt
 - C. mbështetjen në fakte
 - D. mbështetjen në histori

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

Ky autor lindi më 1630 në Gur të Hasit të Prizrenit. Studimet e larta i kreu në kolegjin Ilirian të Loretos dhe në kolegjin e propagandës në Romë. U laurea në teologji dhe filozofi. Filloi punën meshtarë në Pult, kurse në moshën 26 vjeçare u bë ipeshkv i Shkodrës, e më vonë u bë arqipeshkv i Shkupit. Mendohet se këtu përfundoi kryeveprën e vet për të cilën punoi mbi dhjetë vjet (1675 - 1685). Meqë ishte kohë e egër, kur turqit ndiqnin meshtarët dhe dijetarët katolikë shqiptarë, ai e pati të vështirë të ruante dorëshkrimin e veprës së vet në kohën kur, si i përndjekur jetonte në malet e Shqipërisë larg qendrave. Vdiq më 1689 në Prishtinë.

- 13.** Mbështetur në të dhënat e mësipërme biografike që jep ky tekst, për njërin nga autorët e Letërsisë së vjetër shqipe, bëhet fjalë për:
- A. Marin Barleti
 - B. Frang Bardhi
 - C. Pjetër Budi
 - D. Pjetër Bogdani

Në poezinë XVI të veprës “Doktrina e Kërshtenë” të Pjetër Budit, janë vargjet:

*Tashti të lus, ndritmë mua,
Zoti im me një rrezé
.....
Sqip të mundënj me rrëfyem
Ndonjë kankë të ré*

- 14.** Në këta dy distikë del frymëzimi krijues autorial i lidhur për tre elementë, që janë përcaktues edhe të programit poetik të këtij autori:
- A. lutës, rrëfyes dhe entuziast
 - B. tokësor, universal dhe përjetues
 - C. fetar, atdhetar dhe individual
 - D. qiellor, pajtues dhe vëzhgues
- 15.** Këta dy distikë japin natyrën poetike të poezisë:
- A. refleksive
 - B. elegjiake
 - C. përshkruese
 - D. satirike
- 16.** Cilat nga vargjet e poemës: “Këngët e Milosaos” të Jeronim de Radës, shpreh njëri nga format e paradoksit:
- A. *Më jep faqen për të puthur
Më le gërshetin në dorë*
 - B. *Fryu era e maleve
dhe rrëzoi hien e lisit*
 - C. *E përveshur e e lartë,
me gërshet të pleksur*
 - D. *Luleve që valvit era,
posi valë që s'kanë mbarim*

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

Unë nuk pretendoj të jem e zonja të mësoj diplomatin, gjeografin apo arkeologun. Qëllimi im është shumë më modest. Unë dëshiroj t'i jap lexuesit vetëm një ide më të drejtë për gjendjen e ngjarjeve në Gadishullin e Ballkanit nga ajo që ai zotëron zakonisht.

Njerëz të këtyre racave të tjera më janë lutur t'i tregoj të gjitha ato që kam parë e dëgjuar, për të kujtuar publikun britanik se, ka edhe popuj të tjerë veç bullgarëve që duhet t'u merren parasysh interesat, dhe për të theksuar që të hollat që jepen nga njerëz bujarë me qëllim, ashtu si mendohet për të ndihmuar Krishterimin, ka të ngjarë që t'i japë shkak Partisë Bullgare që të mendojë se ajo ka mbështetjen e Anglisë dhe për ta inkurajuar atë të shkaktojë dhuna të reja kundër të krishterëve të tjerë.

Kurse njerëz të tjerë më janë lutur që të mos i tregoj ato që kam parë e dëgjuar.

Është e pamundur t'i kënaqësh të gjithë. Mungesa e vendit natyrisht më pengon që të jap hollësitë e këtij udhëtimi tim të gjashtë, në Gadishullin Ballkanik, por jam munduar që të bëj një përshkrim të thjeshtë të fakteve kryesore. Sukseset që munda të arrij, ua detyroj kryesisht miqësisë së atyre që më ndihmuan gjatë udhëtimeve të mia.

Gabimet janë të gjitha të miat.

(Edith Durham: "Bregna e ballkanasve")

17. Cila fjali e jep më së miri qëllimin e veprës së kësaj autoreje:

- A. Dëshiroj t'i jap lexuesit vetëm një ide më të drejtë për gjendjen e ngjarjeve
- B. Njerëz të këtyre racave më janë lutur t'i tregoj të gjitha ato që kam parë e dëgjuar
- C. Veç bullgarëve që duhet t'u merren parasysh interesat, ka edhe popuj të tjerë
- D. Sukseset ua detyroj kryesisht miqësisë së atyre që më ndihmuan gjatë udhëtimeve

18. Autorja, në fragmentin e këtij teksti, përqendrohet kryesisht te problemi i:

- A. konfliktit midis populli bullgar dhe popujve të tjerë
- B. mbështetjes së Anglisë ndaj interesave të bullgarëve
- C. paanësisë gjatë paraqitjes së dëshmive dhe ngjarjeve
- D. të hollave që jepen nga njerëz për të ndihmuar Krishterimin

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

Enea - Në mitologjinë romake, një princ trojan, i biri i hyjneshës Afërdita dhe i Aniksit. Luajti rol kryesor në mbrojtjen e Trojës kundër grekëve, por kur ra qyteti, u arratis në Kartagjenë. Atje ra në dashuri me Didonën, mbretëreshën vejushë, por e braktisi për të themeluar shtetin e Romës.

19. Ky tekst identifikohet si pjesë e fjalorit:

- A. sinonimik
- B. enciklopedik
- C. të gjuhës letrare
- D. të fjalëve të huaja

20. Cila nga veprat, **nuk** është vepër e autorit të cilit i referohet?

- A. Petro Marko: "Hasta la vista"
- B. Bilal Xhaferri: "Ra Berati"
- C. Martin Camaj: "Sheshi i unazës"
- D. Zejnullah Rrahmani: "Romani për Kosovën"

ENGLISH LANGUAGE

- 21.** Dan won the school award for the best essay. The award included a monthly scholarship of £1,358. He was paid _____ last month.
- A. one thousand, three hundred fifty and eight pounds
 - B. one thousand and three hundred and fifty-eight pounds
 - C. one thousand, three hundred, fifty-eight pounds
 - D. one thousand, three hundred and fifty-eight pounds
- 22.** Lana, Roger, Debbie, and Steven all attend the same school. They spend a lot of time together. They have many things in common. However, this summer they have decided to plan their summer holidays on their own. They will go hitchhiking in Europe.

Look at the table below and choose the correct answer:

	LANA	ROGER	DEBBIE	STEVEN
2nd part of June	Austria	Belgium	Switzerland	France
July	Germany	France	Austria	Belgium
August	France	Germany	France	Switzerland
1st part of September	Switzerland	Austria	France	Germany

- A. Debbie will stay in France for more than a month.
 - B. Debbie will visit the same countries as Lana during the summer.
 - C. All of them will visit Austria during the summer.
 - D. Roger will start with Belgium and end his trip with France.
- 23.**
- 1. Tom wanted to go to a show.
 - 2. They came by car this morning.
 - 3. It is Saturday afternoon and Susan and Tom are in London.
 - 4. After lunch Susan wanted to do some shopping.
 - 5. They arranged to meet for a meal at 6 o'clock.

The correct order of sentences to form a dialogue is:

- A. 3 2 1 5 4
 - B. 1 2 3 4 5
 - C. 3 2 4 1 5
 - D. 4 5 2 1 2
- 24.** ONLY ONE of the words below CANNOT be used to complete the following sentence. Which one?

I don't like this flat! The traffic is very _____ on this road so I find it impossible to concentrate on anything.

- A. strong
- B. heavy
- C. loud
- D. big

25. Read this text and then choose a sentence to complete the paragraph:

Peter got up at dawn. He got into his car and started driving. He drove for ten hours before he arrived home. When he got there, he was very tired because _____.

- A. he had been driving all day long
- B. he didn't want to come home
- C. it had dawned.
- D. it had got dark.

26. In the following dialogue:

Sebastian: Roger Wickham will arrive on a 1250 c.c. Honda motorcycle on Sunday and he'll meet the local schoolchildren.

Caroline: I don't believe my ears. Shall we all go and _____ him?
from the following expressions:

- 1. cheer
- 2. jeer
- 3. shout at
- 4. mock

Maggie should say, '**cheer**' because _____.

- A. this is how we show that we do not like someone or his behaviour.
- B. this is how we show our approval and appreciation to someone.
- C. this is what we do when we are angry or annoyed by someone.
- D. this is what we do when we want to make fun of someone.

27. Choose the correct answer to complete the sentence:

I don't think that this house is _____.

- A. Marys'
- B. Marys
- C. Mary's
- D. Marys's

28. The sentence 'He had told him about that earlier.' is in the _____.

- A. Past simple tense
- B. Past perfect tense
- C. Past continuous tense
- D. Past perfect continuous tense

29. Look at the following adjectives. One of them DOES NOT exist. Which one?

- A. harmonious
- B. prosperous
- C. dangerous
- D. furtitious

30. Choose the best way to join the following sentences:

They are not very happy.

They have a big house and successful careers.

- A. They are not very happy even though they have a big house and successful careers.
- B. They are not very happy and so they have a big house and successful careers.
- C. They are not very happy because they have a big house and successful careers.
- D. They are not very happy since they have a big house and successful careers.

31. Choose the correct sentence:

- A. Just to be with you honest, a lot of the jokes Sam us told went my head over.
- B. Just to be honest with you, a lot of the jokes Sam told us went over my head.
- C. Just with you to be honest, the jokes Sam told us a lot of went over my head.
- D. Just honest to be with you, Sam told us a lot of the jokes went over my head.

32. Look at the words in the box:

objection – pictures – to – of - taking – has - headquarters – no – the – she -

The correct combination to form a question is:

- A. She no objection has to taking pictures of the headquarters.
- B. To taking pictures she has no objection of the headquarters.
- C. She has no objection to taking pictures of the headquarters.
- D. She has no objection of the headquarters to taking pictures.

33. Which word is different?

- A. novel
- B. story
- C. biography
- D. poetry

34. Choose the correct word to complete the following sentences:

The teacher didn't join us for a _____.

They had to _____ through the woods.

- A. drink
- B. class
- C. walk
- D. run

35. Which word below does NOT rhyme with the word also?

- A. window
- B. eyebrow
- C. rainbow
- D. follow

36. In the string of words: **horrible, amazing, terrible, discouraging, insignificant**, the word **amazing** is different because _____.

- A. its meaning is positive
- B. its meaning is negative
- C. it is an adverb
- D. it is an adjective

37. Read the paragraph carefully:

Western Australia is eight times the size of Britain, but it has only one million people. 900,000 of them live in and around the state capital, Perth. The other 100,000 people live in 'the outback', an area of 2,500,000 square kilometres. The area is hot and dry. Temperatures are usually over 30⁰C in summer and sometimes 40⁰C. It hardly ever rains. Sheep farming is the main occupation, and the farms are called 'sheep stations' in Australia. **The children can't go to school, and they hardly ever see a teacher. They have lessons from a two-way radio. It's called 'The School of the Air'. The children can speak to the teacher and other children in the class by radio.**

Look at the highlighted part of the text and complete the following sentence:

The author _____.

- A. doesn't think that the children aren't able to go to school and meet the teacher.
- B. thinks that the children don't want to go to school and meet the teacher.
- C. considers that 'The School in the Air' is the only way for children to get **education**.
- D. thinks that 'The School in the Air' is one of the ways for children to get education.

38. The following sign means that _____.


- A. airplanes are dangerous.
- B. airport is near here.
- C. flights are cancelled.
- D. there is no airport around.



39. It is **one** of the most famous sports in the world. It is played indoors and outdoors. All that is necessary is to have a net in the middle of the field and a ball, and, of course, hands. This sport is popular especially among girls.

The sport is called:

- A. basketball
- B. baseball
- C. volleyball
- D. handball



40. Read the following paragraph:

Samantha went to a restaurant for a quick lunch. She looked at the menu and the price list first. Then she ordered a cheese salad which cost £2.50, a chicken sandwich (its price was £3.20). She had an apple juice for £1.20, and she decided to treat herself with an ice-cream that cost £1.50. The waiter brought the bill for _____.

- A. eight pounds and forty pence
- B. seven pounds and forty pence
- C. nine pounds and forty pence
- D. six pounds and forty pence


MATEMATIKË

41. Cila nga barazitë vijuese është e saktë?

- A. $\frac{a^m}{a^n} = a^{m:n}$
- B. $\frac{a^m}{a^n} = a^{n-m}$
- C. $\frac{a^m}{a^n} = a^{m-n}$
- D. $(a^n)^m = a^n \cdot a^m$

42. Në një rreth janë dhënë 8 pika të ndryshme. Sa katërkëndësha me kulme në ato pika mund të formohen ?

- A. 70
- B. 64
- C. 60
- D. 59



43. Cili nga gjykimet e dhëna është i saktë?

- A. p : Drejkëndëshi ka katër boshte të simetrisë.
- B. q : Ekziston trekëndëshi që ka dy kënde të drejta.
- C. r : $\frac{a^2 - 4}{a + 2} = a, \quad a \neq -2.$
- D. s : $\frac{2}{\frac{5}{3}} + 1 = \frac{11}{5}$

44. Zgjidhjet e ekuacionit kuadratik $(x - 1)^2 - 16 = 0$ janë:

- A. $x_1 = 5, x_2 = -3$
- B. $x_1 = -3, x_2 = -5$
- C. $x_1 = 5, x_2 = 3$
- D. $x_1 = 5, x_2 = 5$

45. Cilat janë zgjidhjet e ekuacionit $\sqrt{1 + \sqrt{5x - x^2}} = 1$?

- A. $x_1 = 0, x_2 = -5$
- B. $x_1 = 0, x_2 = 5$
- C. $x_1 = -1, x_2 = 5$
- D. $x_1 = -1, x_2 = -5$

46. Në qoftë se $z_1 = 3 - 2i$ dhe $z_2 = 2 - i$, ($i = \sqrt{-1}$), janë dy numra kompleks, atëherë pjesa imagjinare e numrit kompleks $z_1 \cdot z_2$ është e barabartë me:

- A. $\text{Im}(z_1 \cdot z_2) = 4$
- B. $\text{Im}(z_1 \cdot z_2) = -4$
- C. $\text{Im}(z_1 \cdot z_2) = 7$
- D. $\text{Im}(z_1 \cdot z_2) = -7$

47. Janë dhënë bashkësitë $A = [1,5]$, $B = [2, 6]$ dhe $C = [3, 10]$. Sa është $A \cap B \cap C$?

- A. $A \cap B \cap C = [1,10]$
- B. $A \cap B \cap C = [1,6]$
- C. $A \cap B \cap C = [3,5]$
- D. $A \cap B \cap C = [3,10]$

48. Janë dhënë funksionet: $f(x) = x^2 - 4$ dhe $g(x) = -\frac{x}{2} - 1$.

Sa është $g(f(-2)) - 1$?

- A. -2
- B. -1
- C. 0
- D. 1

49. Pas thjeshtimit shprehja $\left[1 + \frac{2ab}{(a-b)^2}\right] : (a^2 + b^2), a \neq b$ është e barabartë me:

- A. $a^2 - b^2$
- B. $(a-b)^2$
- C. $\frac{1}{(a-b)^2}$
- D. $\frac{1}{a^2 - b^2}$

50. Shuma e tre numrave të njëpasnjëshëm është 120. Cili prej tyre është më i vogli?

- A. 37
- B. 39
- C. 41
- D. 43

51. Janë dhënë termat $a_2 = 27$ dhe $a_8 = \frac{1}{27}$ të vargut gjeometrik. Sa është herësi q ?


- A. $q = \frac{1}{3}$
- B. $q = \frac{1}{9}$
- C. $q = 3$
- D. $q = \frac{1}{27}$

52. Cila është vlera e termit të parë të vargut aritmetik nëse dihet termi i shtatë $a_7 = 5$ dhe diferenca $d = 3$?

- A. $a_1 = 15$
- B. $a_1 = -15$
- C. $a_1 = 1$
- D. $a_1 = -13$

53. Është dhënë trapezi barakrahës me brinjët paralele $a = 6 \text{ cm}$ dhe $b = 4 \text{ cm}$ si dhe këndi që formon brinja anësore me brinjën e bazës $\alpha = 45^\circ$. Sa është lartësia e trapezit ?

- A. 1
- B. 2
- C. $\frac{\sqrt{2}}{2}$
- D. $\frac{\sqrt{3}}{3}$



54. Është dhënë shprehja $\sqrt{xy} = \frac{\sqrt{x}}{\sqrt{y}} + \frac{\sqrt{y}}{\sqrt{x}}$, $x > 0, y > 0, y \neq 1$. Sa është vlera e x -it ?

- A. $\frac{y}{y+1}$
- B. $\frac{1}{y+1}$
- C. $\frac{1}{y-1}$
- D. $\frac{y}{y-1}$

55. Ndryshimi i dy numrave është 4, ndërsa ndryshimi i katrorëve të tyre është 64. Cilët janë ata numra?

- A. $x_1 = 11, x_2 = 7$
- B. $x_1 = 12, x_2 = 8$
- C. $x_1 = 10, x_2 = 6$
- D. $x_1 = 9, x_2 = 5$


56. Është dhënë $\log_5 3 = b$. Në cilin rast është njehsuar saktë $\log_3 15$?

- A. $\log_3 15 = \log_3 3 \cdot 5 = \log_3 3 + \log_3 5 = 1 + b$
- B. $\log_3 15 = \log_3 3 \cdot 5 = \log_3 3 + \log_3 5 = 1 + \frac{1}{\log_5 3} = 1 + \frac{1}{b}$
- C. $\log_3 15 = \log_3 3 \cdot 5 = \log_3 3 + \log_3 5 = 1 + \frac{\log_5 3}{5} = 1 + \frac{b}{5}$
- D. $\log_3 15 = \log_3 3 \cdot 5 = \log_3 3 + \log_3 5 = 1 + \frac{\log_5 3}{3} = 1 + \frac{b}{3}$

57. Në një zarf gjendet numri y . Për cilin numër është fjala nëse mesatarja e numrave 2, 7, y është 12?

- A. 13
- B. 19
- C. 23
- D. 27

58. Në figurën e dhënë është paraqitur paralelogrami ABCD dhe gjashtëkëndshi i rregullt MNBPDQ te cili vlen $[AM] = [MD]$ dhe $[DQ] = [QC]$. Sa është gjatësia e $[CP]$, nëse dihet se $[DB] = 8 \text{ cm}$?



- A. 2 cm
- B. 3 cm
- C. 4 cm
- D. 5 cm

59. Nëse është dhënë $\frac{1}{2^{-x}} = 3$, atëherë sa është 4^{x+2} ?

- A. 144
- B. 149
- C. 244
- D. 249

60. Është dhënë piramida e drejtë katërkëndore, baza e të cilës është drejtkëndësh me brinjët $a = 12 \text{ cm}$, $b = 15 \text{ cm}$, kurse lartësia $H = 17 \text{ cm}$. Sa është vëllimi i piramidës?


- A. $V = 1020 \text{ cm}^3$
- B. $V = 980 \text{ cm}^3$
- C. $V = 950 \text{ cm}^3$
- D. $V = 920 \text{ cm}^3$

61. Një sportist vrapon 500 metra kah lindja dhe pastaj kthehet prapa duke vrapuar 300 metra kah perëndimi. Nga starti ai e ka përshkruar rrugën me gjatësi:

- A. $s = 500$ metra
- B. $s = 200$ metra
- C. $s = 300$ metra
- D. $s = 800$ metra

62. Cilin ligj e shpreh interpretimi gjeometrik i paraqitur në figurë?

- A. Ligjin e Njutonit për gravitet
- B. Ligjin e parë të Keplerit
- C. Ligjin e dytë të Keplerit
- D. Ligjin e tretë të Keplerit




63. Drita rënësë e bardhë në prizmë optike, zbërthehet në ngjyrat përbërëse, në bazë të dukurisë së:

- A. thyerjes
- B. reflektimit
- C. difraksionit
- D. polarizimit

64. Janë dhënë dy valë a dhe b me karakteristika të ndryshme që tregohen në figurë.


Vala a e ka më të madhe se vala b :



- A. amplitudën dhe frekuencën
- B. amplitudën dhe gjatësinë valore
- C. amplitudën, frekuencën dhe gjatësinë valore
- D. amplitudën, frekuencën, gjatësinë valore dhe elongacionin

65. Duke kujtuar se puna e gazeve në procese të ndryshme, grafikisht njihsohet me sipërfaqen që mbyll segmenti apo lakorja që e përshkruan atë proces dhe boshti i abshisë, cili nga proceset në figurë nuk kryen punë fare?


- A. Izobarik
- B. Izotermik
- C. Izohorik
- D. Adiabatik



- 66.** Sa është frekuenca e valës së ujit, në sipërfaqe të detit, me gjatësi valore 0.5 m nëse përhapet me shpejtësi $12 \frac{\text{m}}{\text{s}}$?
- A. 12 Hz
 B. 24 Hz
 C. 36 Hz
 D. 48 Hz

- 67.** Për sa kohë do të kalojë biçiklisti rrugën Prizren – Pejë të gjatë 72 km nëse lëviz me shpejtësi $10 \frac{\text{m}}{\text{s}}$?
- A. $t = 1.5 \text{ h}$
 B. $t = 2.0 \text{ h}$
 C. $t = 2.5 \text{ h}$
 D. $t = 3.0 \text{ h}$




- 68.** Me ndihmën e gishtit të madh të dorës së djathtë të vendosur mbi solenoid, që tregohet në figurë përcaktojmë:
- A. kahun e rrjedhjes së rrymës
 B. fluksin magnetik të solenoidit
 C. anën veriore të solenoidit
 D. anën jugore të solenoidit




- 69.** Në cilën largësi b nga kulmi i pasqyrës sferike konkave zmadhimi i shëmbëllimit të objektit është $Z=0$?
- A. $b = f$
 B. $b = 2f$
 C. $b > 2f$
 D. $b = \infty$

- 70.** Cili element i rrymës mungon në figurë për ndërtimin e një qarku elektrik?

- A. Rezistori
 B. Burimi i rrymës
 C. Kondensatori
 D. Përçuesi i rrymës



71. Cila nga gjendjet në figurë paraqet këmbim të natyrshëm të përcjelljes së nxehtësisë në mes të trupave?




- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV

72. Nëse trupi lëvizë me shpejtësi të afërt me shpejtësi të dritës gjatësia e tij do të shkurtohet:

- A. në të dy skajet
- B. në kah të lëvizjes
- C. në kah të kundërt të lëvizjes
- D. normal në drejtim të lëvizjes

73. Katër karroca laboratorike që bartin masa të ndryshme lëvizin me shpejtësi të ndryshme sikurse në figurë. Cila gjendje ka sasi të lëvizjes më të madhe?



- A. 4
- B. 3
- C. 2
- D. 1

74. Pllaka e rrafshhtë e ballkonit me gjatësi 8 m dhe gjerësi 2 m është e mbuluar me borë me trashësi 1 m. Sa është masa e borës mbi të, kur dihet se dendësia e saj është

$$\rho = 300 \frac{\text{kg}}{\text{m}^3} ?$$

- A. $m = 4.2 \text{ ton}$
- B. $m = 4.4 \text{ ton}$
- C. $m = 4.6 \text{ ton}$
- D. $m = 4.8 \text{ ton}$

KIMI

75. Si quhet energjia e cila nevojitet për shkëputje të elektronit nga atomi elektroneutral në gjendje të gaztë?

- A. Energji e jonizimit
- B. Energji e disocimit
- C. Afinitet ndaj elektronit
- D. Afinitet ndaj protonit

76. Cili prej këtyre joneve gjendet i kompleksuar me porfirinë në përbërje të klorofilit?

- A. Al^{3+}
- B. Cr^{3+}
- C. Mg^{2+}
- D. Fe^{2+}

77. Në një kupshore porculani është vendosur një sasi e jodurit të merkurit (HgJ_2) dhe kupshorja është ngrohur mbi flakëdhënës. Në këtë rast joduri i merkurit ka marrë ngjyrë të verdhë. Pas ftohjes, përsëri është përfutur substancë me ngjyrë të kuqe. Pse ka ndodhur ndërrimi i ngjyrës pas ftohjes?



- A. Sepse HgJ_2 me ftohje shpërbëhet në Hg dhe J_2
- B. Sepse HgJ_2 me ftohje e ndërron strukturën kristalore
- C. Sepse HgJ_2 me ftohje kalon në gjendje agregate të lëngët
- D. Sepse HgJ_2 me ftohje kalon në gjendje agregate të gaztë

78. Çfarë kanë të përbashkët mes vete elementet e grupit 17 të sistemit periodik?

- A. Numrin atomik
- B. Numrin e masës
- C. Numrin e elektroneve në shtresën e fundit
- D. Numrin e protoneve në bërthamën e atomit

79. Në cilin rast është shënuar saktë konfiguracioni elektronik i atomit të kromit, duke u bazuar në rregullën e diagonales?

- A. $\text{Cr} (Z=24) \quad 1s^2 \quad 2s^2 \quad 2p^6 \quad 3s^2 \quad 3p^6 \quad 3d^4 \quad 4s^2$
- B. $\text{Cr} (Z=24) \quad 1s^2 \quad 2s^2 \quad 2p^6 \quad 3s^2 \quad 3p^6 \quad 3d^6 \quad 4s^2$
- C. $\text{Cr} (Z=24) \quad 1s^2 \quad 2s^2 \quad 2p^6 \quad 3s^2 \quad 3p^6 \quad 4s^2 \quad 3d^6$
- D. $\text{Cr} (Z=24) \quad 1s^2 \quad 2s^2 \quad 2p^6 \quad 3s^2 \quad 3p^6 \quad 4s^2 \quad 3d^4$

80. Cili numër kuantik përcakton kahun e rrotullimit të elektronit përreth boshtit të vet?

- A. numri kuantik spin (s)
- B. numri kuantik kryesor (n)
- C. numri kuantik sekondar (l)
- D. numri kuantik magnetik (m)

81. Është dhënë barazimi i reaksionit kimik të përfimit të bakrit nga xehja e tij me proces pirometalurgjik:




Në cilin rast janë shënuar saktë të dhënat për reaksionin kimik dhe për procesin e përfimit të bakrit?

	<i>Cu₂O është:</i>	<i>Lloji i reaksionit</i>	<i>Mjeti reduktues që përdoret</i>
I	Element kimik	Reaksion i neutralizimit	Oksidi i karbonit (II)
II	Element kimik	Reaksion i oksido-reduktimit	Koksi
III	Komponim kimik	Reaksion i neutralizimit	Oksidi i karbonit (II)
IV	Komponim kimik	Reaksion i oksido-reduktimit	Koksi

- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV

82. Në cilin rast janë dhënë në mënyrë të saktë të dhënat për alkenet?




- A. 1, 2 dhe 4
- B. 1, 2 dhe 5
- C. 1, 3 dhe 5
- D. 2, 4 dhe 6

83. Në cilin rast janë paraqitur saktë të dhënat për natriumin?

	Grupi	Vetitë e përgjithshme	Gjendja oksiduese
I	17-të	Jometal	-1
II	16-të	Jometal	-2
III	1-rë	Metal	+1
IV	2-të	Metal	+1

- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV

84. Në cilin rast është shënuar saktë formula strukturore e acidit klorik (HClO₃)?



- A. I
B. II
C. III
D. IV

85. Sa është përqendrimi sasior i tretësirës ujore të klorurit të litiumit, e cila përmban 0,85g LiCl të tretur në 2000 cm³ tretësirë? Mr(LiCl) = 42,5

- A. $c(\text{LiCl}) = 0,01 \text{ mol dm}^{-3}$
B. $c(\text{LiCl}) = 0,1 \text{ mol dm}^{-3}$
C. $c(\text{LiCl}) = 0,2 \text{ mol dm}^{-3}$
D. $c(\text{LiCl}) = 0,02 \text{ mol dm}^{-3}$

$$c = \frac{n}{V} = \frac{m}{M \cdot V}$$


86. Në cilin rast janë dhënë saktë karakteristikat e përbashkëta për glukozën dhe fruktozën?

	Struktura	Vetitë e përbashkëta
I	Përmbajnë grupin karboksil	Kanë shije të ëmbël
II	Përmbajnë grupin karbonil	Kanë shije të thartë
III	Përmbajnë grupin karboksil	Janë pa shije
IV	Përmbajnë grupin karbonil	Kanë shije të ëmbël

- A. I
B. II
C. III
D. IV

87. Në grafikun vijues janë dhënë entalpitë e formimit të metanit, etanit, etilenit dhe acetilenit. Cilat prej këtyre komponimeve formohen nga karboni dhe hidrogjeni me reaksione ekzotermike?

- A. Metani dhe etani
B. Etani dhe etileni
C. Etileni dhe acetileni
D. Acetileni dhe etani



BIOLOGJI

88. Luani i cili si burim të ushqimit përdorë organizmat bimëngrënës (shtazët) është organizëm:

- A. omnivorë
- B. herbivorë
- C. karnivorë
- D. insektivorë

89. Në cilën pjesë të qelizës kryhet cikli pentozik?

- A. Plastide
- B. Citoplazmë
- C. Ribozome
- D. Mitokondrie

90. Cila nga metodat e menaxhimit të mbeturinave paraqet procesin gjatë të cilit mbeturinat me mjete të posaçme imtësohen, të cilat pastaj largohen përmes gypave të kanalizimit?

- A. Riciklimi
- B. Incinerimi
- C. Fermentimi
- D. Kominucion

91. Në cilin kategori të shtazëve bën pjesë sqepori?

- A. Shpendë
- B. Gjitarë
- C. Zvarranikë
- D. Ujëtokësorë

92. Si pasojë e dëmtimit të trurit të mesëm te njeriu do të:

- A. çrregullohet shikimi
- B. çrregullohet memoria
- C. çrregullohet drejtpeshimi
- D. çrregullohet frymëmarrja


93. Gjatë zhvillimit embrional nga mezoderma zhvillohet:

- A. sistemi nervor, gjëndrat lëkurore, epiteli i zorrëve
- B. indi eshtëror, indi kërcor, zemra, sistemi urogenital
- C. faringu, zgavra e gojës, mëlçia, pankreasi
- D. veshi, zgavra e gojës, zgavra e hundës, kloaka

94. Në figurë është paraqitur sistemi i tretjes dhe disa organe ndihmëse të tretjes te shpendët.


Në cilën prej këtyre organeve të tretjes bëhet absorbimi kryesor i materieve ushqyese?

- A. Në gushë
- B. Në lukth muskolor
- C. Në pankreas
- D. Në zorrën e hollë



95. Te kurrizorët shqisa e shijimit është e lokalizuar në gjuhë. Në cilën pjesë të gjuhës përceptohet shija e njelmët?


- A. VI
- B. I dhe V
- C. II dhe IV
- D. III



96. Në figurë janë paraqitur membranat embrionale te kurrizorët.

Cila nga këto membrana embrionale funksionon si organ i ekskretimit te zvarranikët dhe te shpendët?

- A. Alantoisi
- B. Horioni
- C. Amnioni
- D. Vitelina



97. Cili është gjenotipi i prindërve (pulës dhe gjelit) nëse prej 160 zogjëve (pasardhësve) 120 prej tyre janë me këmbë të shkurtëra dhe 40 janë me këmbë normale?

Gjeni për këmbë të shkurtëra është **dominant (K)** ndërsa gjeni për këmbë normale është **recesiv (k)**.

- A. KK x Kk
- B. KK x kk
- C. KK x KK
- D. Kk x Kk

98. Cila nga bazat e mëposhtme është prezente te ARN-ja e që mungon te ADN-ja?

- A. Adenina
- B. Uracili
- C. Guanina
- D. Citozina

99. Cilët janë kurrizorët e parë të cilët plotësisht i janë përshtatur jetës në tokë?

- A. Peshqit
- B. Shpendët
- C. Zvarranikët
- D. Gjitarët

100. Truri i vogël është qendër për rregullimin dhe drejtpeshimin e trupit dhe koordinator i lëvizjeve që më së miri është i zhvilluar te:

- A. gafortja dhe peshku
- B. peshku dhe ujëtokësorët
- C. ujëtokësorët dhe zvarranikët
- D. shpendët dhe gjitarët